



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2021:124220

Datë: 26.04.2023

Numri i dokumentit: 04222442

PPP.nr.02/2023

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik**, si gjykatë përmbartimore e shkallës së parë, gjyqtari Burhan Berisha-gjyqtar përmbartues, me zyrtarin ligjor Enis Dema, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, me nr i regjistrimit ..., numër i TVSH-së ..., kundër debitorit N. (Sh...) K. nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, më datë 26.04.2023, mori dhe shpalli këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET në tersi SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit, N. K. nga fsh..., Komuna Hani i Elezit, i ushtruar më datë, 24.02.2020, kundër Urdhrit Përmbartues me P.nr.30/2020 të datës 24.02.2020.

II. DETYROHET, debitori që ta bëjë ekzekutimin e propozimit Urdhrit Përmbartimor P.nr.30/2020 i datës 24.02.2020, lëshuar nga përmbartuesi privat Sh. L. si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore aq sa do të llogariten nga organi përmbartues, kjo pagesë do të bëhet në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Kreditore Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, më datën 24.02.2020, në zyrën e përmbauesit privat Sh. H. L., me seli në Kaçanik, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit N. K. nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, ka kërkuar nga përmbauesi që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 575.05€, për shkak të mos pagesës së energjisë elektrike, për periudhën kohore nga data 28.12.2018 e deri më datën 14.01.2020.

Kreditore ka theksuar se debitori e ka shpenzuar energjin elektrike, por të njëjtën e ka paguar kohë pas kohe, e jo sipas faturave të pranuar për muaj. Këtë fakt gjykata mund ta vërteton nga transaksionet e konsumatorit nga e cila vërtetohet se debitori energjinë elektrike e ka shpenzuar ndërsa të njëjtën nuk e ka paguar. Këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8 %, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Përmbauesi privat më datë 24.02.2020, e ka nxjerrë urdhrin P.nr.30/2020, me të cilin e ka lejuar ekzekutimin, po ashtu me këtë urdhrë e ka udhëzuar debitorin që në afat prej 7 ditëve mund të paraqes prapësim kundër urdhrit për përmbarim.

Përmbauesi privat një kopje të propozimit për përmbarim së bashku me urdhrin për lejimin e ekzekutimit, më datën 24.02.2020 i'a ka dorëzuar debitorit, i cili më datë 25.02.2020, ndaj urdhrit përmbaues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.30/2020, i datës 24.02.2020.

Po ashtu ka theksuar se kreditore e kërkon borxhin për periudhën 2018-2020, e bazuar në neni 256 të LMD-së, ky borxh është parashkuar në pjesën më të madhe dhe tek përmbauesi është parashtruar pas afatit ligjor.

Debitori ka theksuar se kreditore kërkesën e ka paraqitur pasi ka kaluar afati i paraparë me neni 71. pika 1.4 të LPP-së, sepse kemi të bëjmë me borxh të viteve 2014-2020. Prandaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës që të anulohet urdhri për përmbarimi dhe të refuzohet propozim për përmbarim.

Përmbarusi privat me datën 02.03.2020, kreditorit i' a ka dorëzuar prapësimin me njoftim për të paraqitur përgjigje në prapësim. Kreditori më datë 02.03.2020, ka paraqitur përgjigje në prapësim dhe ka kërkuar nga gjykata ta refuzoj prapësimin si të pa bazuar, për arsye se debitori energjin e ka shfrytëzuar të njëjtën nuk e ka paguar.

Po ashtu ka theksuar se borxhi nuk është parashkruar sepse me neni 368 të LMD-së, është paraparë se parashkrimi ndërpritet kur debitori e bënë pagesën e energjisë elektrike, e në rastin konkret debitori e ka paguar energjin elektrike, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga transaksionet e konsumatorit nga e cila vertetohet se debitori pagesën e fundit e ka bërë me datën 27.06.2019, pra nga kjo datë është bërë edhe ndërprerja e parashkrimit.

Po ashtu ka theksuar jeton në kushte të rënda ekonomike qka i' a bënë të pamundur pagesën e borxhit edhe për pjesën që nuk është parashkruar, e po ashtu e ka edhe vajzën 6 vjeqare me probleme shëndetësore.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendosi që të refuzojë prapësimin e debitorit, në tërësi si të pa bazuar, sepse debitori bazën për prapësim nuk e ka mbështetur me prova të duhura dhe ato prova nuk ja ka bashkangjitur prapësimit ashtu siq është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së.

Po ashtu nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e parapara në bazë të nenit 71 nga pika (1.1) deri tek pika (1.12) të LPP-së, prandaj gjykata nga arsyet e cekura më lart vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerësoi se kreditori propozimin për përmbarim, e ka bazuar në dokumentin-Transaksionet e konsumatorit DFE-..., të datës 22.02.2020, po ashtu vlerëson se përmbaruesi privat me rastin e lëshimit të urdhrin drejtë ka vepruar sepse është bazuar ne transaksionet e konsumatorit, sepse kjo është konform neneve 21, 22, 27 dhe 29 par.1 pika1.2 të LPP-së.

Gjykata i analizoi pretendimet Kreditori të paraqitura në propozimin për përmbarim dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave ua fali besimin për shkak se ishin të drejta dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë.

Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka kërkuar nga gjykata që prapësimin i debitorit të miratohet dhe të anulohet urdhri dhe propozimi për përmbarim të refuzohet. Këto pretendime gjykata si mori për bazë me rastin e vendosjes sepse debitori energjinë e ka shpenzuar ndërsa të njëjtën nuk e ka paguar.

Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se debitori me propozim për përmbarim e ka kërkuar borxhin i cili është parashkruar, mirëpo gjykata këto theksime të debitorit i refuzoi si të pa bazuara me faktin se debitori me rastin e pagesës e ka ndërprerë afatin e parashkrimit.

Kreditori propozimin për përmbarim e ka paraqitur me datën 24.02.2020 dhe gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar, sepse debitori pagesën e borxhit e ka bërë me datën 27.06.2019. Pra me rastin e pagesës debitori e ka bërë ndërprerjen e përshkrimit, pra propozimin e ka bërë pa kaluar afati prej 1 viti, nga data e pagesës së fundit, këto fakte vërtetohen nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka kërkuar nga të shfuqizohet urdhri përmbarimor për arsyeje se jeton në kushte të rënda ekonomike, këto nuk i mori për bazë për faktin se gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë, sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Qendra për Punë Sociale-Hani Elezit verifikimin se debitori a ka të ardhura të tjera apo vetëm ato nga ndihma sociale. Nga raporti i Qendrës për Punë Sociale Hani Elezit është konstatuar se debitori i është ndërprerë ndihma sociale dhe i njëjti është përfitues i pensionit paraplegjik dhe teraplegjik të fëmijës si dhe është përfitues i pensionit për fëmijë me aftësi të kufizuar.

Gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit janë të pabazuar dhe se nuk janë përmbushur shkaqet e paraqitjes së prapësimin nga neni 71 paragrafi 1 nën par 1-12 të LPP-së, për faktin se nuk plotësohet kushti sipas ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-039 për procedurën përmbarimore konkretisht nenit 14 i cili ka përcaktuar se nenin 85 të LPP-së 04/L-139 është shtuar paragrafi me të cilën përcakton se duhet të përjashtohet përmbarimi edhe "*të ardhurat në bazë të ndihmës sociale*", pasi që debitori nuk është shfrytëzues i ndihmës sociale sipas raportit të Qendrës për Punë Sociale Hani Elezit Nr.Prot.73/2023 të datës 13.04.2023.

Nga sa u theksua më lart dhe duke u mbështetur në neni 29.par 1 pika 1.3 lidhur me neni 77 par 1 dhe 5 të LPP-së vendosi si në disozitiv të këtijë aktvendimi,

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore të cilat do të llogariten nga përmbareuesi privat, bazuar në nenin 13 të LPP-së.

**GJYKATA THEMELORE Në FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

PPP.nr.02/2023 të datës 26.04.2023

Gjyqtari,  
Burhan Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh , nga dita e pranimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.